



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Sh.II.nr.514/2022

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-Dhoma e Shkallës së dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtarë, në konfliktin administrativ, sipas padisë së paditësit S....shpk me seli në magjistralen Prishtinë-Shkup kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, A.nr.1177/18 datës 20.01.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 03.11.2022, merr këtë;

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit S....shpk me seli në magjistralen Prishtinë-Shkup, e datës 22.03.2021, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative- Divizioni Fiskal, A.nr.1177/18 i datës 20.01.2021, Vërtetohet.

A R S Y E T I M

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit S....shpk me seli në magjistralen Prishtinë-Shkup, ndërsa mbetet në fuqi Aktvendimi i Doganës së Kosovës, nr. 07.3/1351/2014 i datës 04.01.2018.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar paditësi, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të: vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, shkeljes esenciale të dispozitave të Kodit Doganor dhe të Akcizave dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, të aprovoj në tërësi si të bazuar ankesën ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal A.nr.1177/18 i datës 20.01.2021 dhe të anulohet aktvendimi për kundërvajtje, si dhe të bëhet lirimi i ndërmarrjes tonë nga përgjegjësia kundërvajtëse. Është bërë interpretim dhe zbatim i gabuar i dispozitave të Kodit Doganor dhe të Akcizave. Ndërmarrja jonë ndryshe nga çdo herë tjetër ka pasur vonës në pagimin e obligimeve për taksat doganore për mallin që e ka lëshuar në qarkullim të lirë, por assesi nuk ka pasur qëllim që të bëjë shmangje ndaj taksave doganore, kjo vonesë ka ndodhur për shkak të ndryshimit të kushteve të shfrytëzimit të autorizimit për depo doganore nga praktikat e mëhershme.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 dhe nenit 194 i LPK-së, në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me Aktvendimin nr.07.3/1351/2014 dt.04.01.2018, ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë S....shpk me seli në magjistralen Prishtinë-Shkup, për rishqyrtimin e aktvendimit nr.2303/2014 dt.07.08.2014 i lëshuar nga Drejtoria Rajonale Prishtinë-Njësi të kundërvajtje doganore, si i pa bazuar.

I pakënaqur me aktvendimin e të paditurës, paditësi ushtron padi në gjykatën e shkallës së parë, duke inicuar konflikt administrativ ndaj të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, respektivisht duke kundërshtuar ligjshmërinë e vendimit administrativ përfundimtar nr.07.3/1351/2014 dt.04.01.2018, si akt administrativ i paligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të provave si në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesorë të mbajtur më datë 20.01.2021, në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, në vështrim të nenit 81G të Ligjit 04/L-102, dhe vërtetimit të gjendjes faktike gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të organit të paditur, merr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit, ndërsa lë në fuqi aktvendimin e Doganës së Kosovës, nr.07.3/1351/2014 dt.04.01.2018.

Në arsyetim ndër të tjera ka theksuar se; nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ gjykata konstaton se subjekti në procedurë ka bërë shkelje në raport me përmbushjen e obligimeve doganore konform autorizimit për drejtimin e një depoje doganore, duke lëshuar mallin në qarkullim të lirë pa e njoftuar Doganën e Kosovës, dhe pa i kryer obligimet doganore. Nga zyrtarët e PMNE, është konstatuar se pala ka lëshuar në qarkullim të lirë nga depoja mallra në vlerë prej 73,111.65€, pa i deklaruar dhe pa i paguar detyrimet doganore në shumën prej 20,175.82, ku paditësi me këtë ka kryer kundërvajtje doganore nga neni 276 pika (v) e Kodit Doganor dhe të Akcizave. Gjoha e shqiptuar në procedurë administrative mbetet në fuqi, pasi që është në proporcion me shkallën e përgjegjësisë, shkallën e rrezikshmërisë, lartësinë e shmangjes së taksave doganore dhe rrethanat tjera për të cilat mund të arrihet qëllimi i ndëshkimit për parandalimin e përsëritjes së veprave të kundërligjshme.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë. Aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje ligjore sipas pretendimeve në ankesë, dhe as me shkelje qenësore të LPK-së, dhe të Kodit Doganor dhe të Akcizave, të cilat Kolegji i vlerëson sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit 194 të LPK-së.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar drejtë ligjshmërinë e aktit përfundimtar-aktvendimit të atakuar nga paditësi, si në vështrim të nenit 81 të Ligjit 04/L-102, me të cilin në procedurën administrative, e gjithashtu sipas aktgjykimit ankimor edhe në procedurë gjyqësore, në mënyrë të plotë është vërtetuar vepra kundërvajtëse doganore e cila i ngarkohet paditësit nga neni 276 pika (v) të Kodit Doganor dhe të Akcizave 03/L-109, që parasheh: personi juridik apo fizik, në qoftë se, nuk vepron në përputhje me kushtet dhe obligimet e përcaktuara dhe autorizimet e Doganës për regjim doganor me pezullim dhe Procedurë doganore me ndikim ekonomik, do të gjobitet me gjobë në të holla në shumë prej pesëmijë (5.000) deri në dhjetëmijë (10.000) €.

Si rezultat i mos respektimit të kushteve të autorizimit DD209 nga paditësi, malli lëndor që ka dal në qarkullim të lirë nga depoja doganore e paditësit, ka qenë obligim ligjor i paditësit që në bazë të autorizimit për depo doganore, ti përmbahet kushteve të autorizimit, ashtu që ta njoftoj të paditurën Dogana e Kosovës, për lëshim në qarkullim të lirë brenda afatit të paraparë, dhe ti paguaj detyrimet doganore.

Andaj, Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerësoi se e paditura ka vepruar drejtë kur paditësin e ka ndëshkuar me gjobë administrative, duke aplikuar dispozitën e nenit 276,

paragrafi (v) të Kodit Doganor dhe të Akcizave 03/L-109, e cila dispozitë përcakton pasojat ligjore në rast të mos respektimit të obligimeve që dalin nga autorizimet Doganës për regjim doganor me pezullim dhe Procedurë doganore me ndikim ekonomik. Kolegji e pranon si të drejtë konstatimin e gjykatës së shkallës së parë se paditësi nuk ka arrit që të mbështes me prova pretendimet e tij në padi sikurse që parashihet me nenin 81F par.1 të Ligjit 04/L-102.

Pretendimet ankimore të paditësit sipas shkaqeve ankimore të cekura si më lartë si dhe theksimet e tjetra si në arsyetim të ankesës, kolegji i shqyrtoi në tërësi si në baza ligjore dhe i refuzon si të pabazuara, sepse gjendja faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë është vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë e po ashtu në mënyrë të drejtë janë zbatuar dispozitat ligjore procedurale të LPK-së, si dhe dispozitat e ligjit material të Kodit Doganor dhe të Akcizave, ku pa dyshim vërtetohet se paditësi ka kryer kundërvajtjen doganore e cila i ngarkohet nga neni 276 pika (v) të Kodit Doganor dhe të Akcizave, sepse nuk i është përmbajtur respektimit të kushteve të autorizimit për drejtimin e një depo doganore, duke e lëshuar mallin në qarkullim të lirë pa e njoftuar Doganën e Kosovës dhe pa i kryer obligimet doganore.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerëson se pretendimet ankimore të paditësit sipas shkaqeve të cekura më lartë, se gjendja faktike është vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo të drejtë dhe është aplikuar gabimisht e drejta materiale, si dhe theksimet ndër të tjera në arsyetim të saj, Kolegji i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i refuzon si të pa bazuara në prova dhe fakte të dëshmuara dhe gjen se gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë prova të mjaftueshme si në vështrim të nenit 81G të Ligjit 04/L-102, nga rezulton se gjendja faktike e çështjes është vërtetuar në tërësi në mënyrë të plotë dhe të drejtë. Paditësi në ankesë nuk ofron prova konkrete lidhur me kontestimin e gjendjes faktike të çështjes sipas mënyrës së vendosur si në organin e paditur Dogana e Kosovës dhe në gjykatën e shkallës së parë. Theksimet e tjera në ankesë se paditësi në këtë rast ka pasur vonesë në pagimin e obligimeve për taksat doganore për mallin që e ka lëshuar në qarkullim të lirë, por assesi nuk ka pasur qëllim shmangjen ndaj taksave doganore, Kolegji, po ashtu, i vlerëson si të pa bazuara, sepse në gjykatë të shkallës së parë, paditësi ka pasur obligim ligjor të dëshmoj provat e kundërta për të dëshmuar gjendjen faktike që ka rezultuar pas verifikimit të mallit nga Njësi për PMNE, ndërsa në anën tjetër si u cek më lartë në hapësirat e depos doganore të paditësit, nuk gjendet malli lendor ndaj të cilit janë pezulluar taksat doganore sipas kushteve të autorizimit për drejtimin e depos doganore.

Mbi këtë gjendje të fakteve Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë dhe organi administrativ përfundimtar i paditur, Dogana e Kosovës, drejtë kanë vërtetuar gjendjen faktike të çështjes në shqyrtim dhe drejtë kanë zbatuar dispozitat ligjore në fuqi, dhe nuk është cënuar e drejta dhe ligji në dëm të paditësit. Pasi që me thëniet në ankesë aktgjykimi nuk vihet në dyshim, i njëjti vërtetohet si drejtë i bazuar në prova dhe ligj.

Nga të lartcekurat e në vështrim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 dhe nenit 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË
Dhoma e Shkallës së Dytë
Kom.Dh.Sh.II.nr.514/2022 me datë 03.11.2022

Kryetari i kolegjit
Krenar Berisha